



ILLYRIAN GUARD SH.A.

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: *Vojsava Zenelaj ,Bulevardi Gjergj Fishta,Kulla Nr.2,kati i dyte,Tiranë.*

Procedura e prokurimit/lotit: “Këpucë me qafa” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” Sh.A -E hapur
Marrëveshje Kuadër

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **REF-77994-08-21-2023**

“ **Këpucë me qafa**” për nevojat e shoqërisë Illyrian Guard Sh.A

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike :**REF-55499-12-29-2022**
“**Loti 1 Këpucë me qafa**”.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Armand Sinani

L22301008D

Vlera *13,477,500 (Trembëdhjetë milion e katërqind e shtatedhjetë e shtatë mijë e pesëqind)*
lekë pa Tvsh.

2.Vojsava Zenelaj

L12330004A

Vlera *14,400,000 (Katërmëdhjetë milion e katërqind mijë)* lekë pa Tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Arsyet E meposhëme:

OE Armand Sinani (person fizik) ka paraqitur një palë këpucë si mostër, si dhe fletët e analizave me mostrat fizike përkatëse.

Në dokumentin e "ILLYRIAN GUARD", me nr.1028/4, dt. 16.06.2023, "Procesverbal – Tipi i kontratës – Mall", te ngarkuar ne sistem me emertimin “argumentimi i Specifikimeve Teknike (kepuce me qafa)” per nevojat e shoqërisë ILLYRIAN GUARD Sh.a, është specifikuar se:

"...komisioni vendosi që këpuca me qafa të jetë me paraqitje të njëjtë me këpucën aktuale të përdorur të shoqërisë me qëllim që furnizimi me këpucë të ruajë uniformitetin brenda shoqërisë". Sipas modelit të zgjedhur për këtë qëllim janë përpiluar Specifikimet Teknike.

OE i lartpërmendur nuk ka respektuar kërkesën për prodhimin e modelit të kërkuar, ku KVO vëren se OE ka bërë këto devijime nga forma dhe paraqitja e këpucës:

1. Këpucët janë qepur me fill në ngjyrë të kuqe, ndërkohë që kërkesa e klientit është që këpuca duhet të jetë me ngjyrë të zezë. Kjo gjë nuk përputhet me modelin e paraqitur në foto dhe shprehur me fjalë në kërkesat e specifikimeve teknike ku shprehet se ngjyra e këpucës të jetë e zezë.
2. Mbërthimi dhe lirimi i këpucës është realizuar me zinxhirë në pjesën e përparme të këpucës, ndërkohë që në kërkesat e specifikimeve teknike është kërkuar të jetë me lidhëse. Kjo gjë jo vetëm është në kundërshtim me kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara, por ky fakt sjell një devijim të uniformës, pasi do të kishim dy lloje modelesh në përdorim deri në kalimin e gjithë personelit në këpucën e re, për shkak edhe të afatit të përdorimit të tyre, i cili është i ndryshëm dhe i lidhur me afatin e vënies në përdorim të këpucëve ekzistuese nga përdoruesit. Kërkesa e specifikimeve teknike citon në pikën 3 të saj se: “këpuca duhet të ketë 16 unaza bronzi në ngjyrën e këpucës dhe lidhese të zezë rreth 125 cm”, dhe specifikon mbërthimin e këpucës me lidhëse.
3. Në specifikimet teknike është kërkuar që këpuca të ketë 16 unaza bronzi në të dy anët e saj për të siguruar lidhjen e saj ndërkohë që këpuca mostër e paraqitur ka gjithsej 36 unaza bronzi të vendosura në 4 rrjeshta në vrimat e hapura për lidhje.
4. Në pjesën e pasme këpuca mostër ka 6 tegele zbukurimi me penj të kuq, ndërkohë që në specifikimet teknike nuk ka asnjë tegel zbukurues përveç tegelit të qepjes së thembrës, duke u shmangur krejtësisht nga modeli i paraqitur në specifikime.
5. Këpuca nga provat praktike të kryera me disa përdorues rezulton të jetë shumë statike dhe jo e përshtatshme për lëvizje të lirshme dhe të shpejta, këto në funksion të situatave operionale që shoqëria jonë duhet të kryejë, si dhe mbajtjen për një kohë të gjatë të tyre në shërbim.
6. Në përfundim shprehemi se ky produkt nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara dhe nuk është i përshtatshëm për Shoqërinë “Illyrian Guard” Sh.a.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*Vojsava Zenelaj ,Bulevardi Gjergj Fishta,Kulla Nr.2,kati i dyte,Tiranë*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 14,400,000 (*Katërmëdhjetë milion e katërqind mijë) lekë pa Tvsh* është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ADMINISTRATORI

Anduel XHINDI